

UDHËZIM
Nr. 2, datë 20.4.2016

**PËR SHFUQIZIMIN E UDHËZIMIT NR. 3, DATË 27.11.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË UDHËZIMIT NR. 1,
DATË 18.7.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E
DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE TË PANDARA””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121, pika 1, e 124, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Udhëzimi nr. 3, datë 27.11.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr. 1, datë 18.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara””, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe kryetarët e bashkive, në juridiksionin e të cilave ndodhen tokat bujqësore të pandara, objekt i qiradhënies, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama